

#shkëndija

JU FTOJMË TË NJIHENI ME THIRRJEN #SHKËNDIJA

Çfarë është nisma #shkëndija?

Programi #shkëndija mbështet me njohuri dhe mentorim të specializuar aktivistë (individë, grupime apo organizata) në procesin e zhvillimit të nismave konkrete për ndryshim me qëllim përmirësimin e jetës së tyre dhe qytetarëve në komunitetin ku ata jetojnë.

Programi #shkëndija është proces mësimi praktik i cili hap mundësi të shumta për secilin që bëhet pjesë, pra është rrugëtim përmes të cilit pjesëmarrësit i bashkohen një rrjeti të gjerë aktivistësh, profesionistësh dhe aktorësh të shoqërisë civile në Shqipëri.

Çfarë mbështetje parashikon programi #shkëndija?


Mbështetja nga programi #shkëndija përfshin:

1 - **Punëtori të tematikave me rëndësi të veçantë për aktivizmin**, ku veçojmë: (a) aktivizmi, organizimi komunitar, dhe advokimi; (b) zhvillimi i aftësive në aktivizëm përmes teknikave të gazetarisë investiguese; (c) si të bashkëpunojmë dhe të përdorim mediat tradicionale dhe alternative; etc. Përmes punëtorive, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të kuptojnë në praktikë procesin e konceptimit, formulimit, zbatimit dhe monitorimit të një nisme.

Këto punëtori do të realizohen nga ekipi i programit #shkëndija në bashkëpunim me njohës shumë të mirë dhe me përvojë të fushave në fokus të punëtorive.

2 - **Mbështetje e vazhduar** me orientim, këshillim, njohuri si dhe angazhim i drejtëpërdrejtë në procese thelbësore. Ky proces do të jetë i shtrirë në kohë përgjatë vitit dhe synon të krijojë kushtet e nevojshme për ta rritur më tej nismën.

3 - **Mundësim të pajisjeve apo shërbimeve thelbësore për ecurinë e nismës**, për pjesëmarrësit më të angazhuar dhe më të përkushtuar të programit.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

#shkëndija

JU FTOJMË TË NJIHENI ME THIRRJEN #SHKËNDIJA

Përse duhet të marr pjesë në programin #shkëndija?

Arsyet janë të shumta, por ne po ndajmë disa:


- Për të ndërmarrë hapa konkretë për zhvillimin dhe zbatimin e nismës/çështjes që ju shqetëson/ përbën interes për ju.
- Për të qënë pjesë e një organizimi dinamik që mbështet zhvillimin e komunitetit tuaj.
- Për të përmirësuar aftësitë tuaja në ngritjen dhe adresimin e problematikave të komunitetit
- Për të kultivuar njohuritë dhe aftësitë tuaja ndryshim-sjellëse;
- Për t'ju njohur më shumë nisma të tjera interesante që janë duke ndodhur, që ju mund të doni t'i bashkoheni apo t'i mbështesni.

Pjesëmarrësit e nismës #shkëndija do të kenë mundësi jo vetëm të mësojnë nga njerëz me përvojë, por dhe të këshillohen dhe mbështeten nga ta gjatë rrugëtimit shumë domethënës dhe shpërblyes të aktivizmit.

Si mund t'i bashkoheni programit #shkëndija?

- 1- Njihuni me thirrjen në faqen zyrtare të Co-PLAN apo mediat sociale.
 - 2 - Vendosni mbi fokusin e nismës dhe nëse do të aplikoni si individ, grup apo organizatë.
 - 3 - Kërkoni informacion të thelluar për aspekte të paqarta për Ju, duke na kontaktuar përmes adresave të email-it (aida_ciro@co-plan.org, daniela_kostandini@co-plan.org, rudina_pasholli@co-plan.org), medias sociale apo duke na u bashkuar në takime informuese.
 - 4 - Aplikoni përmes formularit.
- Çdo hap tjetër do të komunikohet në vijim.

Ju mirëpresim!



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania